

AKADEMIA E SHKENCAVE E RPSSH
INSTITUTI I KULTURES POPULLORE

Sektori i kulturës materiale
Sektori i kulturës shoqërore

ETNOGRAFIA SHQIPTARE

11



TIRANË, 1981

Redaksia:

Spiro Shkurti — redaktor përgjegjës

Abaz Dojaka

Mark Tirta

Abaz DOJAKA

KARAKTERI I LIDHJEVE MARTESORE PARA ÇLIRIMIT

(Gjysma e dytë e shek. XIX deri në prag të Çlirimit).

Martesa është një nga ngjarjet më të rëndësishme të jetës së njeriut. Ajo është baza e krijimit të familjes.

Martesa dhe familja, si dukuri shoqërore, kanë karakter historik. Në procesin e zhvillimit të shoqërisë ato pësojnë ndryshime. Ndryshimet e bazës ekonomike, të strukturës social-klasore, të rendit politik, të jetës shpirtërore etj. kanë sjellë ndryshime në martesë e në familje, në format s tyrs, në përmbajtjen dhe funksionet e tyre shoqërore. Por, siç dihet, ndryshimet e jetës shoqërore nuk pasqyrohen menjëherë në familje dhe në martesë, prandaj, shpeshherë, në zakonet e jetës familjare e të martesës, ndeshen mbeturina, që u takojnë formacioneve ekonomiko-shoqërore të kaluara, madje edhe shoqërisë së lashtë.

Në këtë punim do të përqëndrohemi më tepër në martesën që i përgjigjet familjes fshatare, e cila, para Çlirimit, përbënte shumicën dërrmuese të familjes shqiptare dhe karakterizohej nga mbeturina patriarkale. Në të njëjtën kohë do të prekim edhe martesat në klasat dhe shtresat e tjera të shoqërisë.

Në popullin tonë, në gjysmën e dytë të shekullit XIX deri në vitin 1929 (me vendosjen e Kodit Civil të mbretërisë shqiptare) martesat lidheshin sipas normave të së drejtës zakonore shqiptare. Por normat e kësaj së drejte në krahinat dhe zonat e viseve të ndryshme shqiptare nuk zbatoheshin njësoj. Në zonat malore ato ishin më të forta, ndërsa në zonat e ulëta dhe në qytete ishin dobësuar mjaft, duke u zëvendësuar me norma të reja, që i përgjigjeshin zhvillimit më të madh ekonomik e shoqëror të këtyre zonave.

Edhe në lidhjet martesore brenda zonave fshatare, vihen re ndryshime, që janë si pasojë e ndikimit të normave të së drejtës kanonike dhe të së drejtës së shariatit mbi të drejtën zakonore.

Por, pavarësisht nga larmia e zakoneve të martesës që vihet re në popullin tonë, në të vërtetë në to duket qartë njësia e tyre, të cilën jemi përpjekur ta nxjerrim në pah.

*

* * *

Deri në prag të Çlirimit në vendin tonë martesë ruajti, në përgjithësi, karakterin e lidhjeve të vjetra të saj: një marrëveshje e bërë midis dy familjesh ose midis prindërish, pa pyetur ata që do të martoheshin. Kjo ishte një dukuri e përgjithshme për shqiptarët. Por, më e theksuar ka qenë në klasat e pasura që nusen e djalit të kërkonin ta gjenin doemos nga klasa e tyre. Për këto familje martesë ishte më shumë një marrëveshje për forcimin e pozitës së tyre, fuqisë dhe pasurisë së shtëpisë. Rolin vendimtar këtu duhej ta luanin interesat e shtëpisë dhe jo dëshirat e të rinjve. «Nga interesi ekonomik, — shkruan shoku Enver Hoxha, — lind «epërsia» e mashkullit mbi femrën, lind autoriteti patriarkal mbi fëmijët, lindin martesat pa dashuri, por të pleksura të autorizuara nga prindërit dhe të palejueshme pa pëlqimin e tyre».¹

Në zonat malore, marrëdhëniet familjare martesore trajtoheshin kryesisht sipas normave të së drejtës zakonore.

Sipas saj, djali dhe vajza nuk kanë të drejtë të mendojnë për martesën e vet. «Djali sa të ketë prind, — thuhet në Kanunin e Lekë Dukagjinit, — s'ka tagër me mendue për martesë të vet».² Kjo ishte më e theksuar për vajzën, e cila, edhe nëse nuk i kishte prindërit nuk kishte të drejtë «me mendue për martesë të vet, tagri asht në dorë të vëllazënve e të kushërinjve, ajo do të shkojë për atë për të cilën ta fejojnë».³ Të njëjtat norma përfshihen edhe në Kanunin e Skënderbeut, në Shartet e Idriz Sulit etj.

Materiali i mbledhur prej nesh dhe të dhënat e shumta që ndodhen në arkivin etnografik trogojnë se, në përgjithësi, të rinjtë nuk pyeteshin për këtë ngjarje kaq të rëndësishme të jetës së tyre.

Në krahinat me fshatarë pronarë të vegjël dhe në zonat çifligare, megjithëse e drejta zakonore ishte dobësuar mjaft, normat e saj të martesës, të gërshetuara me normat e së drejtës kanonike dhe të sheriatit, qëndruan më gjatë dhe ishin ato që rregullonin lidhjet martesore. Megjithatë, të rinjtë (sidomos djemtë) pyeteshin, por mendimi i tyre në përgjithësi nuk mund të prishte dëshirën e prindërve.

Kështu ka ndodhur edhe në shtresat zejtare dhe tregtare të qytetit, ku familje të ndryshme të së njëjtës klasë ose shtresë lidheshin me krushqi ndërmjet tyre. Krushqia më e përshtatshme edhe në këtë pjesë të popullsisë së qyteteve, varej jo nga dëshira e të rinjve, por nga interesi i familjes, pavarësisht se merrej miratimi formal i të rinjve.

Pa dyshim, pushteti absolut i prindit i detyrohej dhe pozitës që zinin fëmijët në ekonominë e shtëpisë. Në shumë zona djali nuk kishte pasuri të vetën. Pasuria ishte e përqëndruar në dorën e zotit të shtëpisë. Kështu që fëmija, së bashku me të tjerët, ishte e detyruar të

1) Enver Hoxha, *Mbi problemin e gruas*, Tiranë, 1973, f. 254.

2) *Kanuni i Lekë Dukagjinit* (KLD), Shkodër, 1933, § 40.

3) Po aty, § 31.

punonte në pronën e përbashkët të familjes. Duke mos pasur asnjë lloj të ardhure, i riu nuk ishte në gjendje të përballonte shpenzimet për martesën e vet, (përgatitjet e pajës, harxhimet për dasmën etj.).

Në një pozitë akoma më të nënshtuar ka qenë vajza, e cila nuk pyetej për këtë çështje. Zënia i bëhej e ditur nga e ëma ose ndonjë grua tjetër e shtëpisë. Në kushtet e ekzistencës së moralit feudo-patriarkal, vajzës as që i shkonte ndërmend ndonjëherë se mund të plotësoheshin ëndrrat e rinisë së saj, prandaj ajo shkonte për atë me të cilin e fejonin. «Në Shqipëri, — shkruante Pashko Vasa, — kurrë nuk pyeten zemrat e vashave, kur është fjala për martesë, prindërit bëjnë si duen vetë me to. Të ankohej ose të reagoje kundër vullnetit atëror, kjo gjë do të ishte një krim që vajza e ndershme nuk do të guxonte kurrë ta bënte».⁴

Për zgjedhjen e nuses kujdesej i zoti i shtëpisë, i cili këshillohej jo vetëm me burrat e familjes, por, shpeshherë, edhe me burrat e vëllazërisë dhe të farefisit të vet.

Në krahinat ku vepronte e drejta zakonore, veçanërisht në zonat malore me zhvillim ekonomik e shoqëror më të ulët, autoriteti i të zotit të shtëpisë shfaqej më i fuqishëm dhe fjala e tij vështirë se mund të shkelej. Ndërsa në fshatrat me çifligje me fshatarë të zhveshur nga pronësia mbi tokën, autoriteti i tij ishte më i vogël dhe prandaj ndodhte ndonjëherë që të rinjtë të martoheshin pa pëlqimin e prindërve. Por në këto zona ushtronin një ndikim të madh beu dhe agai, të cilët shpeshherë i detyronin të rinjtë të merrnin si bashkëshortë të zgjedhurit e tyre.

Në zonat pranë qyteteve, në vetë qytetet dhe veçanërisht në disa krahina të Shqipërisë Jugore dhe Juglindore vihet re një farë largimi nga këto parime patriarkale-feudale. Në klasat e pasura, sidomos të qytetit, po edhe të fshatit, autoriteti i prindit po merrte tiparet e pushtetit patriarkal-borgjez, i cili më shumë e rënë hapët se kuqshdo i shihte të gjitha marrëdhëniet nën prizmin e parasë e të fitimit.⁵

Në përgjithësi, me anë të martesës, i zoti i shtëpisë përpiquej të forconte pozitën ekonomike dhe shoqërore, duke lidhur krushqi me shtëpi të së njëjtës shtresë.

Në zgjedhjen e nuses ai kujdesej që vajza të qe në rangun e tij, nga shtëpi e mirë, me kamje, punëtore. Nga ana e tij, edhe babai i vajzës kishte të njëjtat kërkesa për djalin. Sigurisht, duhet bërë dallimi i lidhjeve martesore në mes klasave dhe shtresave të ndryshme të popullsisë. Nuk ndodhte që të lidheshin martesë mes familjesh të pasura dhe të varfëra. Marjtesa behej brenda klasës apo shtresës së popullsisë, kjo ishte e përgjithshme. Megjithatë, ka patur raste që djem nga klasat e pasura (nganjëherë edhe me të meta fizike e mendore) ose burra të kaluar në moshë, të merrnin vajza nga shtresa të varfëra.

4) Pashko Vasa, *Bardha e Temalit*, Prishtinë 1969, f. 25-26.

5) Bajram Mejdiaj, *Disa tipare të martesës para Çlirimit*, «Etnografia shqiptare», VIII, 1976, f. 45.

*
* *
*

Në popullin tonë ndërmjetësimin për martesën e dy të rinjve mund ta merrte kushdo që njihte të dy familjet dhe që e shikonte të përshtatshme lidhjen e tyre me krushqi. Por, kudo në Shqipëri, një rol të madh në këtë drejtim kanë luajtur bijat e martuara, të cilat bëheshin ndërmjetëse për martesën e motrës, kushërirës, vëllait apo kushuririt të tyre. Dhe, pavarësisht se kush do ta bënte reko-mandimin, si rregull, iniciativën për kërkesë e merrte pala e djalit. Ka patur edhe raste që ana e vajzës të bënte kërkesë. Sigurisht, kjo e fundit nuk ka të bëjë dhe nuk është mbeturinë e formës së vjetër të ndërmjetësimit, që i përket periudhës së matriarkatit, kur nëna interesohej dhe ndërhynte për martesën e fëmijëve. Kjo është një dukuri e vonë, që, sipas mendimit tonë, përkon me zhvillimin e marrë-dhënieve kapitaliste në Shqipëri. Ky lloj ndërmjetësimi praktikohet më shumë në shtresat e pasura të popullsisë dhe zbatohet më tepër në qytete.

SHKUESIA

Ndërmjetësimi për kërkesën e një vajze nuk bëhej drejtpërdrejt nga prindërit, por me anën e një personi të tretë, shkuesit. Shkuesia përdorej gjerësisht. Ajo i paraprinte fejesës dhe martesës. Prindërit ia jepnin fjalën shkuesit, i cili ndërmjetësonte për zënieën e vajzës për djalin dhe për martesën e tyre, duke vendosur vetë për këtë çështje, pavarësisht nga fakti që bashkëshortët e ardhshëm as nuk e kishin parë as nuk e kishin njohur njeri-tjetrin.

Në krahina të vecanta të vendit tonë shkuesi thirret me emra të ndryshëm: *shkues, mesit, mbles, lajmës, lyes, krushqar*.

Shkuesi, zakonisht, ishte një mik i të dy familjeve, të djalit dhe të vajzës. Në këtë mënyrë, ai e kishte më të lehtë misionin e tij. Veç kësaj, ai duhet të ishte një person që i njihte mirë zakonet, «njeri i zoti», «i ndershëm», «i dëgjuar» dhe «i pjekur». Këto cilësi i shërbenin shkuesit për përfundimin me sukses të detyrës së tij. Por, padyshim, një detyrë të tillë mund ta merrte përsipër daja e vajzës, që jo rrallë kryente rolin e shkuesit. Në këtë rast, te pala e vajzës nuk krijohet asnjë dyshim për vërtetësinë e fjalëve të dajës në adresë të dhëndrit dhe të familjes së tij.

Detyra e shkuesit ishte sa e vështirë, aq edhe e lodhshme. Ai shkonte disa herë në shtëpinë e vajzës deri sa të bindte prindërit e saj për të mos kundërshtuar kërkesën e bërë⁶. «*O lajmës, o din dushman, / dhe nga ti s'gjetëm derman*», thuhet në një këngë popullore.

6) Për të patur sukses në misionin e tij, shkuesit i jepnin me vete «një mbyllëse shtëmbe, të cilën ai e hidhte fshehurazi në një qoshe të oborrit ose në shtëpi brenda. Kjo bëhej me qëllim që njerëzve të vajzës t'u mbyllej goja e kundërshtimit dhe të pranonin kërkesën e shkuesit. Arkivi Etnografik (AE), 774/50 f. 50. Në disa krahina ky merrte mashën e trazonte zjarrin AE, 14/6, f. 39. 65 ose gratë e shtëpisë i hidhnin në këpucë pak kripë, kurse njera prej

Shkuesi lavdëronte familjen e djalit, si dhe vetë djalin, duke i veshur atij karakteristikat më të mira që duhej të kishte një mashkull: trim, punëtor, i ndershëm, i zgjuar... Por, ato që kishin rëndësi më të madhe ishin të dhënat për shtëpinë e dhëndrit të ardhshëm, për ekonominë e saj, numrin e njerëzve të shtëpisë (sa më e madhe të ishte familja, aq më e fuqishme ishte dhe, si pasojë, edhe më e pëlqyer), për traditat e saj luftarake, për besën burrërinë. Bukur shprehej kjo në Myzeqenë e Vogël, kur njerëzit e shtëpisë i drejtoheshin shkuesit. «Ka lëng? Ka qull? Ka zile e këmborë?». ⁷ Dhe me të vërtetë, preokupimi më i madh i prindërve ishte që vajza të martohej në një familje, ku të mos mungonte, të paktën, buka dhe qulli. Kjo tregon edhe varfërinë e madhe të familjes fshatare, shumica dërrmuese e të cilave nuk mund të siguronin bukën e vitit.

Rrallëherë rastis që ana e vajzës të jepte pëlqimin që me takimin e parë. Kjo ndodhte në ato raste kur të dyja familjet, që donin të lidhnin krushqi, e njihnin njera-tjetrën dhe binin dakord që më parë, ndërsa shkuesi kryente një zakon, pa të cilin nuk mund të zihej një vajzë. Gjithashtu, pëlqimi mund të jepej menjëherë edhe kur shkuesi, ishte daja ose një i afërt tjetër i vajzës, për qëllimet e mira të të cilëve nuk dyshonin. Në raste të tilla i ati i vajzës i drejtohej shkuesit: «Hajde, mos qoftë prishur! Ta kam falë vajzën! Në dorën tënde! Në e gremiç, më paç në qafë mua dhe atë! Në na nderofsh, nderet dhe të mirat të ndjekçin pas me gjithë çke!». ⁸

Por, në shumicën e rasteve përgjigja nuk jepej menjëherë. I zoti i shtëpisë, ndonëse kishte të drejta absolute mbi fëmijët, sipas zakonit, i pyeste burrat e shtëpisë, të vëllazërisë dhe të farefisit, të cilët, të gjithë së bashku, hetonin për shtëpinë dhe për djalin.

I pari që pyetej nga i zoti i shtëpisë ose nga prindi i vajzës, ishte daja. Kjo dukuri vihej re në mbarë popullin tonë, ndonëse me nuanca të ndryshme në krahina të veçanta. Kujdesi i dajës për zgjedhjen e dhëndrit ose të nuses për mbesat dhe nipat e tij ka zanafillën e vet në periudhën e kalimit nga matriarkati në patriarkat, ku «vëllai i

tyre fshinte një anë të dhomës dhe e vinte fshesën përmbys (Visaret e Kombit, (VK), vëll. XIII; Tiranë 1944, f. 29.). Madje, shpupuritja e zjarrit ishte, si të thuash, nisma e bisedës. Në Mirditë shkuesi, thotë duke trazuar zjarrin: «Zjarr na u bëftë biseda». Ndërsa në zonën e Bilishtit, sapo ndonjë mik merrte mashën në dorë dhe fillonte të trazonte zjarrin, kuptohej se kishte ardhur për krushqi. Në Çamëri, biseda fillonte me fjalët e shkuesit, i cili i drejtohej të zotit të shtëpisë për qëllimin e vizitës.

Në disa krahina të tjera shkuesi i drejtohej të zotit të shtëpisë ose të atit të vajzës: «E, or mik, a ma fal çupën? — Se ku do ta mbyt, është puna ime». (AE, 407/45. f. 161) (Myzeqe e Vogël). Në Mirditë ai thoshte: «A je tue ma falë q'atë cucë?» — «Paj, drue se ma mbytë në ujë!»; përgjigjej i zoti i shtëpisë AE, 14/6, f. 39. Në Mursi shkuesi i drejtohej me këto fjalë: «Ne kemi një farë të mirë. E dimë që edhe ju keni një arë të mirë. Të mbjellim farën tonë në arën tuaj e të rriten vllastarë, që t'i kenë zili bota».

7) AE, 407/45, f. 161.

8) AE, 407/45, f. 43.

nënës, farefisi mashkull më i afërmi, sipas së drejtës amtare, quhej ende si njeriu më i afërm»⁹.

Pasi hetohej mirë nga të gjithë, takoheshin me shkuesin në ditën e caktuar dhe i jepnin përgjigjen. Kur pala e vajzës nuk jepte pëlqimin për lidhje krushqie, asnjëherë nuk tregoheshin arsyet e vërteta, duke u përpjekur të mos e fyenin palën e djalit. Kur përgjigjja ishte pozitive, caktohej dita e takimit të të dy palëve.

Në përgjithësi, në vendin tonë, për shërbimin që bënte, nga ana e shtëpisë së djalit i jepej shkuesit një shpërblim simbolik, që në të shumtën shprehej në «një palë opinga» ose në «një palë këpucë», duke patur parasysh dëmin që kishte pësuar, duke shkuar e ardhur nga njëra shtëpi te tjetra. «*Sa palë openga shkeve? Jaho, shkus-o! Dëftoi lalës, t'i pagjuej*»¹⁰. Më vonë këto morën kuptim më të gjerë, «këpucë», që do të thoshte të paguheshin edhe shpenzimet e ditëve të humbura me këtë rast. Nën këtë emërtim mund të bëheshin edhe peshqeshe të tjera dhe nganjëherë, jepeshin edhe shpërblime në të holla.

Duke u ndalur në këtë çështje, vlen të theksojmë se shkuesia duhet të ketë kaluar në tri faza kryesore: faza e parë, kur shkuesi nuk shpërblehej, faza e dytë, kur shkuesi merrte një shpërblim simbolik¹¹ dhe faza e tretë, kur shkuesi për misionin e tij kërkonte një shpërblim të mirë»¹². Në fazën e fundit, kur u përdorën të hollat, qoftë edhe si barasvlerëse të «këpucëve të grisura», s'kemi të bëjmë më me një shpërblim simbolik, por si me një veprim që ndërmerrej nga persona të veçantë për qëllime fitimi. Pra, kjo është koha e degjenerimit të këtij institucioni, periudha e kthimit të tij në një marrëveshje thjesht tregtare, nga e cila shkuesi nxirrte përfitime të mira.¹³

Në periudhën që kemi marrë në studim, të tria fazat e mësipërme të shkuesit kanë qenë të përhapura në popullin tonë. Pra, ka qenë për mendimin tonë mbizotëruese, faza e dytë, kur shkuesi merrte si shpërblim një peshqesh simbolik. Kjo nuk përjashton edhe rastet kur, njerëz të veçantë, të pandërgjegjshëm dhe të shtyrë nga interesa personale, u bënë shkues profesionistë dhe ushtruan këtë «*zanat*» vetëm për fitim. Dhe shkues të tillë ka pasur gati në të gjitha krahinat e vendit tonë.

Të nisur nga interesa personale, duke vënë mbi gjithshka fitimin, këta njerëz shpeshherë lidhnin martesat të papërshtatshme, me diferencat të theksuara moshe, me njerëz me të mëta fizike dhe mendore. Dhe, ndonëse opinioni i prapambetur e reaksionar, klasat sunduese dhe feja e përkrahnin një gjë të tillë, shumica dërrmuese e popullit ishte kundër këtyre qëndrimeve. Gjykimi i shëndoshë popullor në krijim-

9) F. Engels: *Origjina e familjes e pronës private dhe e shtetit*, Tiranë 1970, f. 101.

10) Në Çamëri ka pasur raste që shkuesi nuk merrte asnjë lloj shpërblimi për punën që bënte. Kjo ishte më e theksuar në Çamërinë e Ndëralumit.

11) Dukuria më e përgjithshme ka qenë shpërblimi i shkuesit me një peshqesh simbolik, qoftë edhe këpucë. Kjo ndeshet kudo në vendin tonë.

12) Shpërblimi i shkuesit në të holla, ndeshet në shumë krahina të Shqipërisë, por duhet theksuar se njerëzit që pranonin të shpërbleheshin kështu kanë qenë të rrallë.

13) B. Mejdijaj, ort. cit., 1 76.

tarinë e tij, i ka satirizuar martesat e shëmtuara që bëheshin me shkuesi, si ato me diferencë moshe, martesat në vegjëli etj. Me gojën e të rinjve është shprehur protesta e tyre. «*Më thojshin shoqet mbra-më;/ Merre moj, merre plakun-o/ Plaku kambët si çibuk,/ Shpina e plakut ishte knut,/ Plaku barkun si saksi,/ Plaku buzën si mëlçi,/ Qyqja ç'ta baj plakun-o*»¹⁴. *Ç'ke, vash-o, që lan e qan?/ Laj e qaj se më martun-e;/ Më martune, më dhanë një plak-e;/ Ç'i rash ngjat e gdhina larg-e/ Vinte era, moj si*

ZËNIA (FEJESA) DHE DETYRIMET EKONOMIKE NDËRMJET PALËS SË DJALIT DHE PALËS SË VAJZËS

Zënia e vajzës ishte një marrëveshje ndërmjet zotërve të shtëpive ose prindërve të të rinjve për lidhjen e martesës së ardhshme.

Siç e pamë, zënia nuk bëhej me pëlqimin e të rinjve, por me dëshirën e prindërve dhe me ndërmjetësimin e shkuesit.

Në të kaluarën, për fejesën e dy të rinjve përdroreshin fjalët: *zënie, mblesë, mbulesë, vlesë*. Vajza quhej *e zënë* (e nxanë, e zanë), *e vluar, e mbuluar*, ndërsa djali *i zënë* (i nxanë, i zanë) *i vluar, i mbuluar*. Por, termi më i përdorur ishte *i zënë* dhe *e zënë*.

Në vendin tonë, në përgjithësi, moshja për zënlen e dy të rinjve ka qënë: për vajzat, 12-14 vjeç dhe për djem, 16-18 vjeç. Kjo nuk do të thoshte që prindërit të mos kujdeseshin për zënien e tyre edhe përpara kësaj moshe. Këtë të drejtë ua jepnin prindërve zakonet patriarkalo-feudale, sipas të cilave, babait i njëhej e drejta e pakufizuar mbi fëmijët, pra, edhe e drejta për «zëniën» e tyre në çdo moshë e, ngandonjëherë, edhe para lindjes. Ky zakon për parinë kishte karakter të theksuar politik, sepse nëpërmjet fejesave, krushqive, forcohej familja patriarkale, forcoheshin lidhjet ndërfinnore midis familjeve, përjetësohej pushteti politik i klasave shfrytëzuese.

Siç e thamë, zënia e fëmijëve që në vogëli, që në djep dhe, në ndonjë rast që pa lindur, praktikohesh në shtresat e pasura. Por, në ndikimin e tyre, u shtri edhe në shtresat e tjera të popullsisë, megjithëse ajo praktikohesh rrallë.

Materiali ynë dhe burime të tjera na lejojnë të gjykojmë se kjo dukuri ka qënë më e përhapur në shekullin e kaluar dhe, ndonëse rrallë, praktikohesh në mbarë shqiptarët. «Fëmijët e të dy sekseve fejohen që në djep pa u lejuar që të shihen e të njihen gjatë kohës së fëmijërisë, as kur rriten në moshë, — shkruan Pukvili. — Ndosht shpesh që të fejuarit të mos dinë se i janë premtuar njeri-tjetrit, një rregull i tillë është e drejta dhe e fshehta e prindërve të tyre, të cilët ua bëjnë të njohur kur u do qejfi. Kur mbaron kjo kohë, vajzat zakonisht janë 12 vjeç dhe djemtë 18 vjeç»¹⁶. Duke folur për bajraqt e Pultit: Shalën, Shoshin, Krinin dhe Toplanën, si dhe

14) *Këngë popullore lirike*, Tiranë 1955, f. 123.

15) *Po aty*, f. 128.

16) Pouqueville F.C.H. *Voyage dans la Grèce* Lb VIII, kapitulli IX, Paris 1820-1821.

për Rrëzën e Tepelenës, Hani ve në dukje se «fejesat bëhen kur fëmijët janë ende të vegjël, nganjëherë bile edhe kur lidhen në djep¹⁷, Fejesat e bebeve qenë thuajse krejt të përgjithshme¹⁸, nënvizon Durham.

Në shtresat e mesme dhe të varfëra të popullsisë zënia në djep ose pa lindur fëmijët bëhej me qëllim që të forcohej miqësia ndërmjet dy shtëpive. Marrëveshja bëhej drejtpërdrejt, me marrëveshjen e dy të zotëve të shtëpisë ose të dy prindërve të fëmijëve. Kur dy gra nga shtëpia e tyre ishin me barrë, ata shfaqnin dëshirën që, po që se lindnin njëra djalë e tjetra vajzë, të porsalindurit do të quheshin të zënë ndërmjet tyre. Në ndonjë krahinë bëhej edhe ndonjë ceremoni e vogël dhe, kur lindnin fëmijët me seks të kundërt, lajmërohej me të shtëna pushke se të dy familjet u lidhën me miqësi. Ndodhte që zënia e fëmijëve të bëhej kur këta arrinin 3-4 vjeç. Për ligjësimin e kësaj shkëmbehej edhe buka, domethënë, organizoheshin gosti në të dy familjet.

Lidhur me moshën, është e nevojshme të vëmë në dukje se në popullin tonë, me ndonjë përjashtim, në martesën e vajzave ndiqej radha: më e madhja më parë e kështu me radhë. Kjo respektohej kudo dhe, kush e shkelte, përbuzej nga të gjithë Madje, në zona të veçanta ndodhte që djali, po të kishte motra, nuk martohej para tyre, pavarësisht se mund të ishte më i madh se ato.

Që vajza të quhej e zënë, duhej pa tjetër një ceremoni e rastit, e cila zhvillohej në shtëpinë e vajzës ose në shtëpinë e një të treti (të afërm ose miku të shtëpisë së vajzës). Kjo vizitë në Korçë quhej «të shkelat».

Zakonisht, të dy palët rreth 6 ose 8 vetë, nga 3-4 për secilën palë, pasi mbaronin qerasjen, shkëmbenin nishanet ose dorëzonin shenjën («shejin», si përdorej në Veri). Në përgjithësi, shenjën që ia lëshonin në dorë të atit të vajzës e dorëzonte një i afërt i djalit, nganjëherë edhe i zoti i shtëpisë ose shkuesi. Së bashku me shenjën dorëzoheshin edhe të hollat.

KLD e përcaktonte shenjën të përbërë prej «nji unazë të remët a t'argjanët (tash vonë). . Unaza e dhetë grosh janë me kanun»¹⁹. Në Kosovë vinin në tryezë unazën, dhe një koronë argjendi, që ishte shenja se u dha fjala. Kjo tregonte që vajza ishte lidhur e nuk mund të jepej gjetiu. Edhe në jug të Shqipërisë, sipas materialit që kemi mbledhur në shumë zona, jepej një shenjë e tillë. «Nishani zakonisht është një pare e vjetër floriri ose sermi, e cila nuk qarkullon në treg»²⁰. Në shumë krahina të Shqipërisë, veçanërisht në veri, së bashku me unazën jepej edhe një shami. Shamia është shenjë rituale që tregonte se vajza ishte e «mbuluar» apo e «zënë».

Në zonat malore dhënia e shenjës ishte një farë kapari, që pala e djalit i jepte asaj të vajzës. Mbas shenjës askush tjetër s'kishte të drejtë të vinte dorë mbi atë vajzë, ndryshe do të binte në gjak.

17) Hahn. G. *Albanesische Studien*, Vjenë 1854; f. 329.

18) E. Durham: *Some tribals, origins, laws and customs of Balkans*, London 1928, f. 201.

19) *KLD.*, parag. 41.

20) G. Hahn, *Vep. cit.*, f. 330.

Në fillimin e saj shenja, siç duket, ka qenë një objekt i vetëm që nuk shoqërohej me ndonjë plaçkë tjetër. Më vonë u shoqërua me një numër të caktuar objektesh dhe, shpeshherë, edhe me të holla.

Duke iu referuar materialit tonë për krahinat e ndryshme të Shqipërisë, vëmë re se kjo dukuri na paraqitet si më poshtë: Në Malësi të Madhe, pasi merrej miratimi për zënien e vajzës, caktohej afati, kur do të dorëzohej «çmimi i nuses». Në këtë datë i zoti i shtëpisë apo shkuesi dorëzonte pjesën e parë të «çmimit», domethënë paret e unazës, që përbënin kaparin. Me kursin e sotëm të të hollave kjo shumë arrinte deri në 500 lekë. Zakonisht shumën e të hollave e kërkonte miku.

Në Malësi të Gjakovës, para se të pihej kafja e zënies, shkuesi merrej vesh për punën e «mesitit», shpërblimit që pala e djalit duhej t'ia jepte anës së vajzës. Mesiti në fillim shprehej me dhurata të ndryshme për të afërmit e vajzës, si p.sh.: të atit një dhjetëshe turke (revole), vëllait një mauzer, dajës së vajzës një sahat me qostek, sëmës dhjetë kokë dhi. Më vonë «mesiti» u kërkuar në të holla që arrinin 3000 deri në 5000 lekë²¹.

Në Nikaj-Mërtur, gjatë kohës së zënies së vajzës lihej si kapar një shumë të holla, të cilat i merrte i zoti i shtëpisë. Në fillim vlera e kaparit ishte e papërfillshme: një mexhide, një koronë ose një lek. Ka pasur raste që si kapar është përdorur një shami, një sapun, madje edhe një cigare duhan. Por, këto shërbenin vetëm sa për zënien e vajzës. Më vonë bëhej marrëveshja për «pazarin e cikës», që zakonisht pritej 12 qese serme (baraz me 12 napolona flori). Nga këto, gjysma ishin të hollat e unazës, 6 napolona (baraz me 3000 deri në 4000 lekë)²².

Në Lumë (Kukës), kur vinte mahrama (një shami që i jepej shkuesit si shenjë se i ati pranonte të jepte vajzën), familja e djalit, me anën e shkuesit, i çonte vajzës disa dhurata si lesh, pambuk, bojëra të ndryshme etj., si dhe disa të holla që quheshin «pare hupsa», sepse nuk llogariteshin në «forcë», në shumën që do t'i caktohej dhëndrit për nusen²³. Edhe në fshatin Golaj të rrethit të Kukësit familja e djalit çonte 500 deri 2000 lekë si kapar për zënien e vajzës²⁴.

Në Domgjon (Mirditë), natën e zënies së vajzës, prindi i djalit së bashku me shkuesin lëshonin unazën, një shami dhe një sasi të hollash, që arrinin 3000 deri 5000 lekë. Unaza dhe shamia i takonin nuses, kurse të hollat familjes së saj²⁵.

Në Fushë-Arrëz (Pukë), pala e djalit çonte shenjën, që përbëhej nga një unazë e një rubë e kuqe, si dhe një shumë të hollash²⁶.

Në Lezhë, me këtë rast përveç unazës së argjendit dhe shamisë (që ishin të vajzës) shtëpia e djalit dërgonte edhe disa të holla, sasia

21) M. Memia, *Dasma e Malësisë së Gjakovës*, «Etnografia shqiptare» I, 1962 f. 278.

22) M. Memia, *Martesa dhe lindja në Nikaj-Mërtur*. AE f. 8.

23) Shefqet Hoxha, *Fejesa dhe martesa në Lumë*; «Bul. i USHT, seria shkencat shoqërore», 1960, nr. 4, f. 247.

24) AE, 516/23, l. 66-67.

25) AE, 466/9, f. 37-38.

26) AE, 515/22, f. 16.

e të cilave varej sipas kërkesës së mikut. Në qoftë se miku tregohej i arsyeshëm, atëherë shuma ishte e vogël dhe arrinte deri në 300 lekë. Por, kishte raste kur ai kërkonte 1000 lekë. Këto të holla shërbenin si kapar, quheshin pare *nan gju* dhe përdroreshin nga i zoti i shtëpisë si të donte²⁷.

Si shenjë në Mat cohej një unazë, një shami dhe 200 grosh²⁸. Ndërsa në Mirditë shenja zakonisht ishte më e shtrenjtë. Në Kushnen, në të kaluarën, paguanin një shumë që shkonte nga 3000 deri në 4000 lekë²⁹. Po kaq paguanin edhe në Kthellë të Epërme dhe në bajraçet e tjera të Mirditës.

Për zonën e Kurbinit³⁰ kemi këtë të dhënë: Ditën e zënies së vajzës i ati i djalit dërgonte në shtëpinë e vajzës shenjën, që përbëhej nga një unazë, një shami mëndafshi dhe një peshtaf, brenda të cilit vendoseshin sendet e tualetit. Veç këtyre, babai i dhëndrit dërgonte edhe 500 deri në 2500 lekë (kjo varej nga gjendja ekonomike e shtëpisë së djalit), të cilat, të shumtën e herëve, shpërdoroheshin nga pala e vajzës. Kishte edhe raste kur këto të holla familja i përdorte për përgatitjen e rrobave të vajzës.

Edhe në krahinën e Tiranës,³¹ sidomos në Malësi, pala e dhëndrit paguante një sasi të hollash për zënie e vajzës.

Në Hasdushk³² (Rrogzhihë) dhe në Rostej³³ (Durrës) familja e djalit i jepte një sasi të hollash palës së vajzës. Shuma e tyre caktohej nga i ati i kësaj dhe nga shkuesi.

Duke zbritur në krahinat e Jugut kjo dukuri paraqitej e zbehtë ose nuk shfaqej fare. Në Korçë dhe rrethet e saj, në Ersekë, Përmet, në disa zona të Gjirokastrës (Lunxhëri, Zagori qytet), në Çamëri e ndonjë vend tjetër kapari nuk përdorej. Ndërsa në Bërzeshtë³⁴ (Librazhd) kjo dukej shumë qartë. Ka qenë zakon që, për të zënë një vajzë, babai i djalit atë ditë që çonte nishanet, i jepte të atit të vajzës nëpërmjet shkuesit një sasi të hollash si kapar, për të siguruar zënie.

Nga të dhënat e mësipërme, del se kjo dukuri ka qenë më e theksuar në zonat malore, ndërsa në zonat me fshatarë të vegjël dhe çifçinj pothuaj nuk paraqitej fare. Megjithatë mendojmë se në një të kaluar të largët kjo dukuri ka qenë për gjithë shqiptarët. Këtë, siç do ta shohim edhe më poshtë, na e tregon e drejta e anës së vajzës për të kërkuar shpenzimet e pajës nga shtëpia e djalit, gjë që shfaqej edhe në zonat jomalore. Por, edhe atje ku nuk shfaqej, të dy palët bënin përgatitje për martesën dhe shpenzimet ishin të dyanshme. Në këto zona kishte marrë një zhvillim të madh shkëmbimi i nishaneve. Sigurisht duhet bërë dallimi ndërmjet shtresave dhe klasave të shoqërisë shqiptare të asaj kohe: klasat e pasura paguanin më shumë për

27) AE, 539/11, f/95.

28) Kahreman Ulqini, *Doke, veshje e besime në Mat*, «Bul. i USHT. Seria shken. shoq.», 1960 nr. 4, f. 255.

29) AE, 470/13, 1 63-66.

30) AE, 471/41.

31) AE, 434/2, f. 60-61.

32) AE, 465/5, f. 31.

33) AE, 460/4, 1 31.

34) AE; 840/123, pyetja 35.

nishanin. Por, edhe në shtresat e mesme dhe, në një masë më të vogël, edhe në shtresat e varfra të popullsisë, nën ndikimin e drejtpërdrejtë të shtresave të pasura, shkëmbimi i nishaneve mori një përhapje të madhe, duke u bërë një barrë e rëndë për ekonominë e shtëpisë.

Shkëmbimi i nishaneve, që praktikohet më shumë në jug të Shqipërisë dhe në qytete, mori një zhvillim të madh vecanërisht nga gjysma e dytë e shek. XIX deri në prag të Çlirimit, kur Shqipëria kishte hyrë tashmë në rrugën e zhvillimit të marrëdhënieve kapitaliste. E theksuar ka qenë në qytetet e Korçës, Shkodrës, Gjirokastrës, Tiranës, Beratit, Vlorës etj. dhe në fshatrat rreth qyteteve të jugut. Madje, në Korçë kjo kishte marrë formën e një gare midis familjeve të ndryshme, kush të shpenzonte më shumë. Kaq e vërtetë është kjo, sa në vitin 1826 burrat e komunitetit ortodoks të Varoshit të Korçës, duke parë shpenzimet e tepërta që bëheshin me rastin e lindjeve, fejesave, martesave dhe vdekjeve, morën vendime të posaçme për kufizimin e tyre. Vendimet e vitit 1826³⁵ për kufizimin e ceremonive dhe shpenzimeve familjare gjatë kohës së fejesës dhe të martesës, dolën nga nevoja e kohës, pasi ato rëndonin shumë ekonominë e familjeve dhe masat e gjera nuk u bënë dot ballë. Këto vendime kufizonin në një masë të mirë shpenzimet që bëheshin për fejesa e martesa. Por, më vonë, në vitin 1835,³⁶ mbledhja e gjerë e meshkujve të rritur të komunitetit të Varoshit, duke shqyrtuar vendimet e marra më 1826, në kushte të reja, zgjeroi këto vendime dhe lejoi të bëheshin shpenzime më të mëdha.

Gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX shpenzimet për fejesat dhe martesat u zgjeruan akoma më shumë, sidomos në shtresat e borgjezisë së re tregtare dhe të zanatcinjve të qytetit, të cilët përpiqeshin të imitonin shtresën e borgjezisë tregtare të Selanikut e të Manastirit, me të cilët ishin në kontakt. Kjo gjë u shtri edhe në shtresat e tjera të qytetit. Prandaj, duke parë përmasat e mëdha që kishin marrë këto shpenzime, banorët e qytetit iu drejtuan Këshillit të pleqve të Komunitetit për kufizimin e tyre. Që në vitin 1905³⁷, nga Komuniteti ortodoks i Varoshit të Korçës u hartua «Kanonizma e re» që kufizonte shpenzimet për lindjet, fejesat, martesat dhe vdekjet. Lidhur me fejesat, kufizoheshin shpenzimet në ceremoninë e shkëmbimit të nishaneve e të tjera. Nyja 6 e kësaj kanonizme thotë: «Që sot e tutje shkëmbimi i nishanit³⁸ të bëhet jo zyrtarisht³⁹, të pritet zakoni

35) Petraq Pepo, *Materiale dokumentare në lidhje me ambientin familjar shtëpiak të Korçës, më 1826, 1835 dhe më 1905*. Dorëshkrimi f. 1.

36) Petraq Pepo, *po aty*, f. 1.

37) P. Pepo, *po aty*, f. 17.

38) Në Korçë ceremonia e shkëmbimit të nishaneve kryhet në shtëpinë e prindërve të së fejuarës, Me këtë rast, mblidheshin farefisi, shokë e miq të familjes së dhëndrit, gra e burra dhe, kur errej, shkonin në shtëpinë e nuses; edhe aty gjenin të mbledhur për pritjen e njerëzve të dhëndrit të afërmit e nuses, shokë dhe miq të familjes së saj. Vajza e fejuar dilte me tabaka në dorë për të gostitur krushqit. Vjehri, duke uruar, i jepte asaj nishanin, zakonisht i varte një flori në qafë. Me monedha floriri dhe me peshqeshe të tjera e dorovitnin nusen edhe krushqit. Kjo ceremoni quhej «shkëmbimi i nishaneve» ose, siç e quante populli i Korçës; «të shkëmbur».

39) Jo zyrtarisht do të thoshte të vinte dhëndri vetëm me njerëzit e shtëpisë.

që prindërit e të fejuarit dhe prindërit e së fejuarës, të afërmit dhe miqtë për këtë qëllim (që të marrin pjesë në ceremonitë e shkëmbimit të nishanit), të mos shkojnë (për të dëfryer) një palë me tjetrën në shtëpinë e të fejuarve.⁴⁰

Edhe në qytetin e Shkodrës zënia e vajzës bëhej me shpenzime të mëdha. Për këtë, në vitin 1910 dolën sullat (rregullat) për kufizimin e tyre. «Fejesat pas sodit, thuhet në këto sulle, kanë për t'u ba në këtë mënyrë: Pare as dupe nuk guxon me dhanë kërkush sado zengjin që të jetë»⁴¹... Më poshtë caktohej shuma e sendeve që duhej t'i dërgoheshin nuses ditën e fejesës dhe vlera e secilës prej tyre.

Por edhe pse u morën këto vendime që, për kohën, ishin pozitive, sepse luftonin zakonin e keq të shpenzimeve të tepërta në fejesa dhe në martesë, harxhimet jo vetëm nuk u kufizuan, por u shtuan edhe më shumë, veçanërisht në shtresat e pasura të qytetit. Dhe, nën ndikimin e qytetit, kjo dukuri u shtri edhe në fshatrat dhe në disa qytete të tjera si: në Ersekë, Leskovik, Përmet, etj. duke u bërë kështu, një sëmundje që sa vinte e shtoej.

Ajo që e rëndonte më shumë ekonominë e familjeve, ishte pagesa e palës së dhëndrit për përgatitjen e nuses apo zakoni që përgatitjet t'i bënin të dy palët ose pjesën më të madhe ta bënte nusja (gjë që shprehej edhe në dhënie e prikës).

Por kjo dukuri nuk paraqitej kudo njëllëj. Në zonat malore, në ndonjë rast edhe në zonat me fshatarë të vegjël dhe çifçinj, për pajën e nuses paguante shtëpia e dhëndrit. Për ta parë këtë më konkretisht po paraqesim materiale për disa krahina dhe zona të vendit tonë.

Në Malësi të Madhe⁴², në fillim të shekullit tonë, për zënie e një vaje paguhej 70 deri 140 korona dhe nganjëherë edhe 600. Shuma varej në radhë të parë nga gjendja ekonomike e familjes së vajzës, por edhe nga ajo e familjes së djalit. Pra, familja e një vaje me gjendje të mirë ekonomike kërkonte një shumë të hollash më të madhe se një familje e mesme ose e varfër.

Pagesa bëhej në të holla, por ka pasur raste që bëhej edhe në natyrë. Në Malësi të Vogël në vend të të hollave jepnin edhe kafshë ose armë, në Malësi të Madhe vetë armë.

Në Zadrimë⁴³, në vitet 1906-1909, shuma që shtëpia e djalit i jepte asaj të vajzës shkonte 300 deri 400 korona. Kjo shumë, që shërbente për rrobat e nuses, mund të paguhej edhe me këste.

Në Malësi të Gjakovës⁴⁴ paguante vetëm familja e djalit. Ajo, veç të hollave, i dërgonte familjes së vajzës edhe 50 kg lesh, 20 kg. pambuk (penj), bojëra, etj.

40) P. Pepo, *mat. i cit.*, f. 18.

41) *AE*, 355/33 f. 186.

42) F. Nopça, *Pikëpamje fetare, doket e zakonet*, Arkivi i Institutit të Historisë, f. 167.

43) F. Nopça, *po aty* f. 162.

44) M. Memia, *art. cit.*, f. 284.

«Për teshat e vajzës paguante vetëm pala e djalit», thuhet në një material nga zona e Nikaj-Mërturit. Vlera arrinte deri në 5000 lekë dhe gjysma paguhej në të holla dhe gjysina në natyrë.

Sipas një të dhëne që kemi për krahinën e Lumës⁴⁵, gjatë regjimit të Zogut, në kohën e zënies së vajzës, i ati i djalit «priste forcën, këpucët», domethënë merrte vesh se sa të holla duhej t'i dërgonte mikut. Kjo shumë arrinte 20 deri në 30 napolona. Vërtetë miku i merrte të hollat, por ai i kthente përsëri në një formë tjetër, në plaçkat që përgatiteshin për vajzën.

Në Pukë⁴⁶, në të kaluarën, pala e vajzës i përgatiste gjithë rrobat e saj, por të hollat për këto i paguante pala e djalit.

Në Mat⁴⁷ «pritet hesapi» gjashtë muaj para dasmës. Shkuesi me prindin dhe disa nga farefisi i vajzës shkonin në shtëpinë e djalit dhe aty caktonin sa rroba duhej të bënte dhëndri për nusen, numrin e dyshekëve, velenxave dhe qilimave, si dhe orenditë e kuzhinës.

Në Lezhë⁴⁸ dhe në malësi të saj ana e vajzës i kërkonte anës së djalit të gjitha shpenzimet për rrobat e nuses. Të hollat paguheshin herë pas here gjatë periudhës së fejesës dhe arrinin deri në 7000 lekë.

Zakonisht, në Mirditë⁴⁹ të gjitha rrobat e nuses bëheshin me të hollat që dërgonte pala e dhëndrit dhe arrinin në 7000 deri në 8000 lekë. Por, përveç këtyre, kur caktohej dita e dasmës, «priteshin këpucë», që ishte detyrimi i dytë i palës së dhëndrit kundrejt asaj të nuses dhe qëshkonte deri në 2000 lekë.

Në Malësi të Krujës⁵⁰, në shumicën e rasteve, nuk caktohej shuma e të hollave që duhej të paguante shtëpia e dhëndrit. Por, pavarësisht nga kjo, sipas traditës, dhëndri duhej të paguante 7000 deri në 10.000 lekë. Kishte edhe raste kur kjo shumë kalohej, duke e varfëruar së tepërmi shtëpinë e djalit. Kur nuk arrihej shuma e të hollave, ajo plotësohej me bagëti, tokë etj.

«Për plaçkat e gjës, thuhet në një material nga Malësia e Tiranës⁵¹, kryetari i familjes së djalit i jepte nënës së vajzës 40 okë lesh për rrobat e leshta. Pjesa tjetër e plaçkave që nuk mund të përgatiteshin në fshat (si p.sh.: dyshekët, jorganët këpucët, enët e bakrit, si dhe arka e nuses) do të bliheshin në qytet me të hollat e dhëndrit».

Në fshatrat e Durrësit, Kavajës e të Rrogozhinës babai i djalit ishte i detyruar të paguante të gjitha shpenzimet që bënte pala e vajzës për plaçkat e vajzës⁵².

Në disa zona të Librazhdit⁵³, në kohën e zënies së vajzës, i ati kërkonte të holla për përgatitjen e saj. Kishte dhe raste që në vend të të hollave të kërkonte 5-6 kokë bagëti të imta dhe një ka ose një lopë.

45) «Illyria», Tiranë 1936, nr. 45.

46) AE, 515/22, f. 22.

47) K. Ulqini *art. cit.*, I 231, AE, 509/16, f. 14.

48) AE, 539/11.

49) K. Shtjefni, *Doke mirditore*, «Etnografia shqiptare», II, 1963, f. 280.

50) AE, 537/9.

51) AE, 434/2, I 61.

52) AE, 460/4, f. 50; Andrea Stefi. *Materiale etnografike*, AE, vëll. 55, f. 219.

53) AE, 840/123, pyetja 35, 37.

Në Myzeqe³⁴ babai i vajzës i kërkonte të atit të dhëndrit një shumë të hollash që quheshin para «argëlleku», velenxën dhe rrobat e nuses. Nganjëherë, në vend të argëllëkut në të holla kërkoheshin bagëti, numri i të cilave varej nga gjendja ekonomike e shtëpisë së djalit dhe mund të arrinte në 20-40 krerë bagëti të imta, një pendë qe ose buaj, një kafshë pune, etj. Argëllëku merrej edhe në disa fshatra të Mallakastrës së Butë si në Kurjan, Mbërs⁵⁵ etj. Madje, në Kurjan, në vend të të hollave kërkoheshin edhe bagëti e bereqet.

Edhe në krahinën e Labërisë, sipas zakonisht, shtëpia e dhëndrit paguante një shumë të mirë të hollash për përgatitjen e placrave të nuses. Në Kurvelesh, në zonën e Salarisë, Buzit dhe Krahësit, me rastin e martesës, shtëpia e dhëndrit duhej të paguante «argëllëkun», rrobat e nuses, të cilat i zgjidhte babai i nuses dhe i paguante i ati i dhëndrit⁵⁶. Edhe në bregdetin e Himarës⁵⁷ familja e djalit paguante një sasi të hollash për përgatitjen e rrobave të nuses.

Në shumë krahina të Shqipërisë së Jugut dhe në qytetet ku marrëdhëniet kapitaliste ishin më të zhvilluara shtëpia e dhëndrit nuk kishte ndonjë detyrim shtrëngues për përgatitjen e plaçkave të nuses. Ato i bënin së bashku të dy palët. Madje, në këto zona, familja e vajzës shpenzonte më shumë. Në Çamëri, të gjitha rrobat e nuses i përgatiste i ati i saj kurse dhëndri çonte disa dhurata për nusen dhe të afërmit e saj.

Duke iu referuar materialit tonë, vëmë re se kjo formë kishte përhapje më të madhe. Ajo, veç qyteteve kryesore ngërthente edhe pjesën më të madhe të fshatrave të Shqipërisë së Jugut dhe asaj Juglindore.

Në qytetin e Shkodrës dhëndri i bënte nuses veshjen e plotë, sende tualeti, si dhë disa peshqeshe për njerëzit e saj. Ndërsa nusja, nga ana e saj përgatiste teshat për vete dhe të gjitha të falurat (dhuratat) për njerëzit e burrit. Veç këtyre i ati i vajzës do t'i jepte së bijës edhe shumë enë e orendi të ndryshme.

E njëjta gjë vihej re edhe në qytetet e tjera gjë që e kemi përmendur në pjesën për shkëmbimin e nishaneve.

Por, edhe në fshatra kjo dukuri filloi të marrë një përhapje të madhe. Familja e djalit përgatiste rrobat e fjetjes (dyshekë, jorganë dhe jastëkë) si dhe një ose dy veshje të plota për nusen. Nusja, nga ana e saj, bënte veshje të tjera për vete dhe daroven për njerëzit e burrit.

Në të gjitha fshatrat e krahinës së Çamërisë shumicën e pajës e përgatiste ana e vajzës. Djali çonte vetëm dhurata për nusen e të afërmit e saj. Madhësia e pajës së vajzës varej nga gjendja ekonomike e familjes. Megjithatë, edhe ato që ishin të varfër përpiqeshin ta bënin këtë sa më të plotë, pavarësisht se rrëzonin ekonominë e shtëpisë.

54) Ll. Mitruhi. *Dasma në lalët e Myzeqesë*, «Etnografia shqiptare II, Tiranë 1963, f. 181.

55) AE, 774/58, f. 51.

56) Koço Nova, *Forcimi i familjes dhe lufta kundër zakoneve prapanike*, «Drejtesia popullore», 1967 Nr. 9 f. 83.

57) P. Gjidede. AE, 411/45, f. 56.

Në disa qytete, si: në Shkodër, Korçë, Ersekë, Leskovik, Përmet, përveç pajës që përgatiste vajza, i ati i jepte asaj edhe prikë, një pjesë të pasurisë së familjes (pasuri të patundshme ose në të holla). Ndonëse prika si institucion është e vjetër, ajo mori një zhvillim të madh në kohën e feudalizmit, kur familjet e mëdha mbretërore dhe princërore, me qëllim që të lidhnin aleanca në mes të shteteve dhe principatave të ndryshme, bënë krushqi me njera-tjetrën, duke u dhënë vajzave krahina të tëra, të cilat kalonin në pronësinë e burrave të tyre. Dokumente të ndryshme flasin për aleanca të tilla edhe nëvëndin tonë. Në shek. XIII, në vitin 1258 nevoja për aleancë e shtyn Mihalit II të Epirit të lidhte aleancë me Manfredin Hohenshtaufen, princin e Tarentit, duke i dhënë për grua bijën e vet, Helenën, dhe në formë prike një varg qytetesh të Shqipërisë, si Durrësin, Vlorën, Kaninën, Beratit etj.⁵⁸

Kjo traditë vazhdoi të përdoret edhe nga dyert e mëdha feudale arbëreshe në shekujt e mëvonshëm. Vajzat e familjeve të mëdha feudale, kur martoheshin, merrnin prikë toka të mëdha. Gjon Muzaka në testamentin e tij thotë se Vlora dhe Kanina kanë qenë të Muza-këve dhe i ishin dhënë prikë mbesës, Regina, që u martua me despotin e Serbisë.⁵⁹ Dhënia e prikës vazhdoi edhe nga familjet e pashallarëve dhe të agallarëve. Por, më e theksuar u bë kjo në shek. XIX në qytetin e Korçës, veçanërisht në shtresat e borgjezisë së re të cilat, shfrytëzonin dhënieën e prikës për të patur mundësi t'u siguronin vajzave një jetë bashkëshortore sa më të mirë, duke i martuar në shtresat më të larta të shoqërisë⁶⁰, P.sh., J. V. Halla, rreth viteve 1870, i dha së bijës gjysmën e fshatit Rëmbec. Duhet thënë se dhënia e prikës, mori një përhapje të gjerë edhe në shtresat e mesme të popullsisë dhe u shtri edhe në zonat fshatare të elementeve ortodokse të Shqipërisë së Jugut, duke u bërë kështu një barrë e rëndë për ekonominë e familjes së vajzës. Në popullsinë e krishterë shqiptare të Çamërisë (Gumenicë, Grikohor, Kushovicë, Peshtan, Kastriçë, Ledhëzë etj.), përveç pajës, vajzës i jepej si prikë edhe ndonjë dyqan, vreshtë, ulli, tokë buke ose të holla. Kjo ka qenë më shumë karakteristike për shtresat në gjendje të mirë ekonomike. Edhe në shqiptarët e Greqisë⁶¹ prika ka qenë diçka e kohës dhe madhësia e saj ishte në varësi të gjendjes ekonomike të familjes së vajzës.

Nga të tre rastet e shtjelluara më lart del se shpenzimet për martesat ishin një barrë e rëndë për ekonominë e familjeve. Prandaj,

58) *Acta et Diplomata*, I 245, 1258, *Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë*, vëll. II, f. 66, 99. Dokumenti, midis të tjerash, thotë: «Mihali II despot i Epirit, bijës së vet Helenës, që do të bashkohet me martesë me Manfredin, princin e Tarentit, i jep si prikë përveç ishullit të Korfuzit, dhe kështjellave të Sopotit (Subotum) dhe të Butrintit, edhe disa kështjella e vende në Arbëri: Durrësin, Vlorën, Kaninën, Beratit, malet e Spiranicës»

59) *Ch. Hopf. Chroniques Greko-Romanes*, Berlin 1873, f. 290-291.

60) Andrea Nathanaïli, *Materiale dokumentare për institucionin e prikës*, «Studime Historike», 1975, nr. 2, f. 180.

61) Petro A. Furiqi, *Martesa dhe simbolet e martesës në shqiptarët e Sallaminës*, Athinë 1927, f. 265.

për të siguruar shumën e të hollave që nevojiteshin për pajën dhe për shpenzimet e dasmës, në përgjithësi, i zoti i shtëpisë merrte masa të ndryshme, shiste tokën ose kullotën, bagëti të imët ose të trashë, hynte në borxhe etj. Jo rrallë, ai conte një ose dy djem të shtëpisë (shpesh edhe dhëndrin) për të punuar në familjet e pasura, në qytete, madje edhe në kurbet (siç ndodhte në krahinat e Jugut) deri sa të siguronin të ardhurat për shpenzimet e dasmës. Kjo plagë e rëndë e shoqërisë shqiptare të paraqlirimit u kufizua disi nën shtytjen e masave popullore. Megjithatë, deri në prag të Çlirimit ajo ishte problem dhe mund të zhdukej vetëm me përmbysjen e marrëdhënieve të vjetra në prcdhim.

*
* *
*

Duke analizuar materialin e mësipërm, lidhur me detyrimet ekonomike që kishin të dy palët e lidhura me krushqi, mund të nxjerrim këto përfundime:

Pagesa që shtëpia e dhëndrit i bënte shtëpisë së nuses, paja dhe prika, janë institucione të ndryshme, të pavarura nga njeri-tjetri, dhe secili k.a linjën e vet të zhvillimit.

Në rastin e parë, domethënë kur pala e dhëndrit jepte një shpërblim për zënien e vajzës (shenja, dhënia e materialeve të ndryshme ose dërgimi i të hollave për përgatitjen e rrobave të nuses, dhuratat e shumta të familjes së dhëndrit për njerëzit e nuses etj. flasin për mbeturina të blerjes së grave.

Lindja e institucionit të blerjes së grave i takon etapës së parë të zhvillimit të matriarkatit. «Me lindjen e martesës me çifte fillon rrëmbimi dhe blerja e grave»,⁶² shkruan Engelsi.

Por edhe më vonë, me zëvendësimin e matriarkatit me patriarkatin dhe me lindjen e familjes patriarkale, martesë me të blerë mori një zhvillim edhe më të madh. Këtë e tregon edhe interesimi i të gjithë anëtarëve të komunitetit familjar, të cilët ndihmonin në grumbullimin e shpërblimit që do t'i jepej familjes së gruas. Pra, martesë me të blerë është karakteristikë e marrëdhënieve patriarkale dhe është e lidhur me familjen e madhe patriarkale, pavarësisht se lindja e saj i përkiste periudhës së matriarkatit. Siç duket nën ndikimin e marrëdhënieve të reja shoqërore martesë me blerje rritej e forcohej së bashku me rritjen e prirjeve patriarkale, deri sa arriti zhvillimin e plotë me lulëzimin e marrëdhënieve patriarkale. Me shpërbërjen e familjes së madhe patriarkale dhe me lindjen e familjes së vogël u zhduk edhe blerja e gruas, kurse tepruan vetëm mbeturinat e saj. Por, zhdukia e këtij institucioni nuk tregon se u ndryshua baza e martesës aic nuk e humbi karakterin e saj si një marrëveshje ekonomike. Me lindien e familjeve të vogla, kur gruaja i humbi të gjitha të drejtat e trashëguara që më parë dhe kur u rrit rëndësia ekonomike e punës së burrit (që zinte degët kryesore të aktivitetit prodhues), puna e

62) F. Engels, *vep. cit.*, f. 69.

gruas në shtëpi zuri një vend gjithnjë e më të madh. Kjo përcaktoi edhe fatin shoqëror të saj, të cilin e plotësonte edhe martesa me të blerë. Tani familja-ekonomi e shikonte çdo pjesëtar si forcë pune, prandaj, duke dhënë vajzën tek djali, familja e saj kërkonte kompensimin përkatës. Në fillim kjo shprehej me dhuratat, që familja e dhëndrit i çonte familjes së nuses. (në radhë të parë të atit dhe s'emës, pastaj vëllezërve, dajës së nuses dhe të afërmeve të tjerë). Me zhvillimin e shkëmbimit tregtar, vlera e punës së gruas, veç objekteve në natyrë, mori shprehjen e saj edhe në të holla. Kështu lindi «çmimi i gruas».

Është ky «çmimi i gruas» që zihet ngojë në të drejtën tonë zakonore, në Kanunin e Lekë Dukagjinit⁶³ dhe në materiale të tjera.

Por duke gjykuar në bazë të materialit tonë për gjysmën e dytë të shekullit XIX deri në prag të Çlirimit, nuk mund të flasim për martesë me të blerë. Ajo ka qenë kapërcyer prej kohësh nga populli ynë, duke na lënë si trashëgim mbeturinat e saj dhe jo më tepër se mbeturina, Madje, edhe këto mbeturina kanë qenë të kufizuara në zonat malore dhe rrallë në zona të tjera.

Paja dhe prika, si institucione, kanë lindur në periudhën e shturrjes së familjes patriarkale, me ndarjen e saj në familje të vogla. Vajza që martohej, duke u larguar nga ekonomia e familjes, merrte një farë pjese nga pasuria kolektive e saj. Kjo përbënte pasurinë personale të gruas së martuar, të veçantë nga pasuria e shtëpisë së burrit, pasuri që e dispononte në mënyrë të lirë dhe mbi të cilën nuk mund të vinte dorë askush, bile as burri. Kjo pasuri që, deri në një farë shkalle, përbënte bazën e pavarësisë së gruas, në popullin tonë quhej *salem* në Veri, *pekuli* në Jug.

Me thellimin dallimit klasor dhe me rritjen e forcave prodhuese, paja dhe prika morën një zhvillim të madh. Që në kohën e vjetër, klasat dhe shtresat e pasura, për të mos copëzuar ekonominë e përbashkët të familjes, si kompensim të pjesës së vajzës, filluan të jepnin një shumë të drejtë trashëgimie në familje. Duke filluar nga shek. V e këtëj në shumë popuj asnjë martesë nuk bëhej pa pajë e pa prikë. Në këtë periudhë u zhvillua paja me plaçka-veshmbathje, enë e orendi të ndryshme etj.

Edhe në kohën e feudalizmit u ruajt kjo mënyrë e lidhjes së martesës, në bazë të së cilës qëndronte interesi ekonomik. Madje, në feudalizëm, familjet e mëdha, për të forcuar pozitën e tyre për të krijuar aleanca të ndryshme, i martonin vajzat e tyre me familje të forta duke u dhënë një prikë të majme, e shprehur kjo në pasuri të patundshme që nganjëherë arrinte në krahina të tëra.

Paja dhe prika morën një zhvillim edhe më të madh në kapitalizëm. Duke shndërruar çdo gjë në mall, prodhimi kapitalist i çduku

63) Në Kanunin e Lekë Dukagjinit gjejmë këtë përcaktim: «Çmimi që nepej për varza e gra, tash 50 vjet e andej, përbëhej prej 50, 100 mje 400 groshësh. Çmimi i Kanusë së vonë përbahet prej 1500 groshëve, aq sa ban gjaku i grues» (KLD nye e nëntëmbëdhjetë).

në një masë të madhe marrëdhëniet e lashta, të trashëguara nga e kaluara. Martesa me llogari, martesë me përfitim material, u bë lloji kryesor i martesës në radhët e borgjezisë. Kjo klasë shtron përpara martesës në radhë të parë qëllime ekonomike, e shikon atë jo si bashkim njerëzish, por si bashkim kapitalesh, si një mjet për të grumbulluar pasuri të reja. Në shumë vende kapitaliste legjislati i jep të drejtë burrit të administrojë pasurinë e familjes, duke përfshirë edhe pasurinë (prikën ose pajën) e gruas.

Pra, zakoni i marrjes së pajës, pavarësisht nga origjina e tij e lashtë, e ka burimin në pronësinë private mbi mjetet e prodhimit dhe, si pasojë ai është një zakon i trashëguar nga shoqëria me klasa antagoniste.

Ky zakon, që e ka burimin në trashëgiminë dhe paprekshmërinë e pronës së klasave të privilegjuara (sepse vetëm ato kanë qenë në gjendje t'u jepnin fëmijëve pajë dhe prikë të madhe) u bë një zakon masiv. Paja dhe prika ishin baza me anën e të cilave matej vlera e të reja që do të martheshin.

Edhe në popullin tonë, si e pamë, paja dhe prika kishin marrë një përhapje relativisht të madhe, por madhësia e tyre varej nga gjendja ekonomike e familjeve. Ato kishin përmasa më të mëdha në klasat e pasura, megjithatë, nën ndikimin e këtyre klasave, u përhap mjaft edhe në shtresat e tjera të popullsisë, duke u bërë një plagë e rëndë për shoqërinë shqiptare të paraçlirimit.

Materiali që parashtrua, tregon se në krahinat malore dhe në ndonjë rast, edhe në zonat me fshatarë të vegjël dhe çifçinj mënyra kryesore për të lidhur martesë ishte detyrimi që pala e djalit kishte kundrejt palës së vajzës (e shprehur kjo në dhënie e bagëtisë, të hollave, dhuratave të ndryshme). Ky detyrim ndryshonte nga njera krahinë në tjetrën, duke u varur kryesisht nga gjendja ekonomike e shtëpisë së djalit që marthohet. Por, pavarësisht nga kjo, pa plotësimin e detyrimeve që cekëm më lart, nuk bëhej martesë.

Në zonat e tjera të Shqipërisë, veçanërisht në ato të Jugut dhe në qytetet, ose nuk gjejmë detyrimin ekonomik të palës së djalit kundrejt vajzës, ose gjejmë vetëm gjurmë të tij. Veç kësaj, në këto vende luante rol të madh, paja që babai i jepte vajzës kur bëhej martesë.

* *
*

Pas Çlirimit, me vendosjen e pushtetit popullor dhe të marrëdhënieve të reja socialiste në prodhim, në lidhjet martesore vihen re ndryshime të rëndësishme cilësore. Tani, në vendin tonë, bazën e martesës nuk e bën interesi ekonomik, por njohja e ndërsjelltë e të rinjve, dashuria e pastër dhe e sinqertë, interesi i tyre i përbashkët për ndërtimin e shoqërisë socialiste.

Résumé

LE CARACTERE DES RAPPORTS CONJUGAUX AVANT LA LIBERATION DU PAYS

L'auteur soumet à un examen circonstancié les rapports conjugaux avant la libération du pays. Il s'agit du lien conjugal qui correspond à la famille rurale. On fait mention, dans quelque cas, aussi des mariages chez les autres classes et couches de la société.

En Albanie, jusqu'à la Libération du pays, c'était les parents qui devaient se soucier pour le mariage de leurs fils, sans rien demander, au préalable de leur assentiment. Tout de même, l'entremise pour la demande de la main d'une jeune fille, n'était pas le fait direct des parents. On employait à cette fin l'entreprise d'une troisième personne, le marieur. Les parents donnaient leur parole au marieur, qui faisait d'intermédiaire pour la quête de la jeune fille. Les parents étaient les seuls à décider sur cette question, indépendamment du fait que les futurs conjoints ne s'étaient jamais connus auparavant.

Dojaka, s'arrêtant d'une façon plus circonstanciée, sur l'institution du marieur, constate que celle-ci a passé par trois phases principales: La première phase c'était lorsque le marieur ne recevait aucune compensation pour son entremise; la deuxième phase c'était lorsque celui-ci ne recevait que, comme compensation symbolique, une paire de mocassins ou de chaussures; la troisième phase c'était celle lorsque le marieur réclamait une bonne compensation à mesure de la réussite de sa mission.

Dojaka parle ensuite des fiançailles proprement dites et des obligations économiques entre la partie du jeune homme et la partie de la fille.

Comme terme technique on employait, au lieu du terme actuel, *fejesë* «fiançailles», d'autres termes, voire: *zënie* «engagement», *mblesë* «alliance», *vlesë* même sens. Pour le jeune couple, on avait les dénominations suivantes: la fille: *e zënë* «engagée», *e vluar* «alliée par parenté», *e mbuluar* «couverte dans le sens d'engagée»; le jeune homme: *i zënë* «engagé», *i vluar* «parent par alliance», *i mbuluar* «couvert dans le sens d'engagé». La différence entre l'une et l'autre passe du simple féminin au masculin.

L'engagement du jeune homme et de la jeune fille représentait un jalon important dans le mariage albanais. Il était suivi par une série de pratiques que sont: *l'échange du gage, les arrhes déposées pour la préparation du trousseau, le trousseau et la dot*. Ces questions sont analysées en détail par l'auteur, s'agissant que les différences entre régions ou groupes ethnographiques sont assez fortes, et puis il y a les différences découlant de la condition sociale. L'auteur illustre ces particularités en tirant des exemples et des données effectives de chacune des régions ethnographiques composant le pays. Il arrive aux conclusions suivantes:

1. En Albanie du Nord, Albanie centrale et dans quelques zones particulières de l'Albanie du Sud, la façon principale à contracter mariage était celle de l'obligation économique que se prenait la partie du jeune homme envers celle de la jeune fille. En d'autres termes, les arrhes consistaient dans la concession de cheptel, d'argent comptant, etc., pour former la somme nécessaire à la préparation des parties du trousseau et des dons nécessaires à ces cérémonies.

2. Le trousseau et la dot jouaient un rôle important dans les contractations matrimoniales. Ils ont apparu dans la période de la dissolution de la famille patriarcale, par sa subdivision en petites familles. La fille mariée, qui s'éloignait de

l'économie de la famille paternelle, avait le droit de prendre une certaine quote-part de l'économie collective. C'était ce qui formait son avoir personnel, l'avoir de la femme mariée, distinct des avoirs de son mari. Il s'agissait de certains avoirs qui constituaient, dans une certaine mesure, aussi la base de son indépendance dans la famille conjugale.

Le trousseau et la dot avaient pris une forte envergure dans les formations socio-économiques aux classes antagonistes. C'était une mesure par laquelle on estimait les valeurs des jeunes à marier.